


# Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

**Prill, 2021**

**Tiranë, më 19 Maj 2021:** Ndryshimi vjetor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit në muajin Prill 2021 është 2,1 %. Rritja më e madhe e çmimeve prej 3,6 % vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike”, pasuar nga grupet “Transporti” dhe “Komunikimi” me 3,4 % secili, “Pije alkoolike dhe duhan” me 2,3 %, “Shëndeti” 1,0 %, “Argëtim dhe kulturë” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,9 % secili, “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,7 % secili, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,3 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” u ulën me 0,1 %.


Në muajin Prill 2021, ndryshimi mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është 0,1 %. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të grupit “Argëtim dhe kulturë” me 1,7 %, pasuar nga grupet “Komunikimi” me 1,3 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,4 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,3 % secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” u ulën me 0,6 %, pasuar nga “Shëndeti” 0,5 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”, “Shërbimi arsimor” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,1 % secili.

**Fig. 1 Ndryshimet vjetore dhe mujore të IHÇK**




Për publikim 19/05/2021

Vijon

**Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor****Tab. 1 Ndryshimet në përqindje matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit**

Kodi	Grupet	Peshat	04-21/Viti-2020	04-21/12-20	04-21/04-20	04-21/03-21
	<b>Gjithsej</b>	<b>1.000,0</b>	<b>3,3</b>	<b>3,9</b>	<b>2,1</b>	<b>0,1</b>
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	362,1	7,3	9,7	3,6	0,3
02	Pije alkoolike dhe duhan	53,8	1,8	1,0	2,3	0,4
03	Veshje dhe këpucë	42,1	0,1	-0,1	0,0	0,0
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	62,3	0,2	0,1	0,3	-0,1
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	66,9	0,8	0,6	0,7	-0,6
06	Shëndeti	53,0	1,0	1,0	1,0	-0,5
07	Transporti	87,5	1,5	0,5	3,4	0,0
08	Komunikimi	23,6	3,0	2,7	3,4	1,3
09	Argëtim dhe kulturë	27,0	1,4	1,5	0,9	1,7
10	Shërbimi arsimor	40,6	-0,1	0,0	-0,1	-0,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	144,4	0,7	0,6	0,7	-0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	36,8	0,4	0,0	0,9	0,3

**Fig. 3 Ndryshimi vjetor i IHÇK sipas Shteteve, Prill 2021**

# Metodologjia

Nga muaji Janar 2017, INSTAT publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i llogaritur në bazë të:

1. Rregullores së KE Nr 2494/95
2. Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare
3. Programit të Statistikave Zyrtare, 2017-2021.

Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së Klasifikimit Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore. ECOICOP është klasifikimi i shpenzimeve i përdorur nga EUROSTAT.

Periudha referuese e çmimeve është muaji Dhjetor 2019, ndërsa periudha referuese e indeksit është muaji Dhjetor 2020 (Dhjetor 2020=100).

Peshat për IHÇK janë llogaritur në përputhje me Rregulloren e KE Nr. 2494/95 dhe Rregulloren e KE Nr. 1688/98. Peshat reflektojnë strukturën e Shpenzimeve Monetare të Konsumit Final të familjeve shqiptare dhe jo shqiptare në territorin e Shqipërisë.

## - Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti IHÇK shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkontëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistonë në:

- Përditësimin e peshave
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

IHÇK duke filluar nga muaji Janar 2021 do të llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 do të shërbejë si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

INSTAT gjatë periudhës së Pandemisë ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjera ndërkontëtarë.

## - PËRKUFIZIME

**Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit** (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korrente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit koren me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.

## Krahasimi midis IÇK-së dhe IHÇK-së

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë hartuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguara për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

### - Ngjashmëritë midis IÇK dhe IHÇK

- *Qëllimi*

IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit.

- *Sistemi i klasifikimit*

IÇK dhe IHÇK përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve - Klasifikimi Evropian i Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP)

- *Shpenzimet dhe burimi i të dhënave të shpenzimeve*

Përfsihien vetëm shpenzimet brenda territorit të Shqipërisë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve.

- *Të dhënat e çmimeve*

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në çmimet e mbledhura në të njejtat njësi tregtare, përdorin të njëjtën klasifikim të produkteve dhe ndajnë të njëjtën metodologji të hartimit të indeksit.

- *Periudha referuese (bazë) t*

IÇK dhe IHÇK llogariten duke pasur si periudha referuese muajin Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015=100)

- *Metodologjia*

IÇK dhe IHÇK ndjekin metodologjinë e përcaktuar në Rregulloren e Komisionit Evropian (KE), Nr 2494/95, mbi IHÇK, për hartimin dhe grumbullimin e komponenteve të indekseve të çmimeve, e cila është zhvilluar nga Eurostat (Zyra e Statistikave e BE-së) në bashkëpunim me Institutet Statistikore Kombëtare të vendeve anëtare të BE-së.

### - Dallimet ndërmjet IÇK dhe IHÇK

- *Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit*

- IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri
- IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.

- *Mbulimi i produkteve*

- IÇK përmban 331 produkte
- IHÇK përmban 329 produkte

- *Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)*
  - Në IÇK mbulohen vetëm shpenzimet e familjeve private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
  - IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, përfshirë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri.
- *Peshat*
  - Në IÇK peshat janë shprehur në për 100
  - Në IHÇK peshat janë shprehur në për 1000

Kodi	Grupet	Peshat	
		IÇK	IHÇK
	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>1.000</b>
01	Ushqime dhe pijë joalkoolike	34,9	362,1
02	Pije alkoolike dhe duhan	3,8	53,8
03	Veshje dhe këpucë	4,3	42,1
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,7	62,3
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajje	7,9	66,9
06	Shëndeti	3,5	53,0
07	Transporti	5,3	87,5
08	Komunikimi	3,1	23,6
09	Argëtim dhe kulturë	3,4	27,0
10	Shërbimi arsimor	3,0	40,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,0	144,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	7,2	36,8